



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

INTERVISTË E KRYETARIT TË PREZENCËS, AMBASADORIT EUGEN WOLLFARTH ME “ALBANIAN DAILY NEWS”

Botuar më 8 shkurt 2013

ADN: Duket qartë që Zyra e OSBE-së në Tiranë është plotësisht e angazhuar me zgjedhjet e përgjithshme që do të mbahen në Shqipëri më 23 qershor 2013. Z. Ambasador, mund të na tregoni pak më shumë në lidhje me asistencën që ju ofroni, hapat që do të pasojnë deri në fund të procesit?

Ambasadori Wollfarth: “Prezenca e OSBE-së u ofron asistencë autoriteteve shqiptare në lidhje me zgjedhjet, si një nga fushat kryesore të mandatit të saj. Vitin e kaluar, Prezenca ofroi këshillim teknik dhe lehtësoi dhënien e ekspertizës nga OSBE/ODIHR-i Kuvendit, gjatë të gjithë ciklit të reformës zgjedhore. Prezenca po ndjek nga afër të gjitha zhvillimet dhe do të vazhdojë t’i ndjekë edhe gjatë periudhës paszgjedhore. Ne bazohemi në përvojën dhe në bashkëpunimin shumë të mirë që kemi pasur me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në të kaluarën për t’i ofruar atij mbështetje për rritjen e kapaciteteve të tij profesionale dhe teknike. Kështu, ne do të asistojmë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me trajnimin e komisionerëve të nivelit të mesëm dhe do të mbështesim fushatën e tyre të edukimit të zgjedhësve. Do të printojmë dhe do t’ua shpërndajmë Kodin Zgjedhor të sapondryshuar aktorëve të përfshirë në proces. Kam shpresë se kjo asistencë do t’i japë mundësi Komisionit Qendror të Zgjedhjeve t’i përgatisë dhe zhvillojë zgjedhjet në përputhje me standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, Prezenca do të asistojë edhe OSBE/ODIHR-in në organizimin e një Misioni të suksesshëm dhe efikas të OSBE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, në përgjigje të ftesës së marrë në fund të dhjetorit nga qeveria shqiptare”.

ADN: Duke pasur parasysh faktin se duket qartë se ekziston një atmosferë e ashpër në skenën politike, ku, si shumica, ashtu edhe opozita, shkëmbejnë akuza të forta – cili është opinionin juaj në lidhje me këtë retorikë, e cila, në fakt, ka vazhduar për vite me radhë, ndërkohë që kanë mbetur pesë muaj deri në ditën e zgjedhjeve? A e dëmton një atmosferë e tillë fushatën normale zgjedhore në një kohë kur të gjithëve u kujtohet situata pas zgjedhjeve të 2009-s?

Ambasadori Wollfarth: “Nuk është as e pazakontë dhe as e papritur që tashmë po hyjmë në një periudhë fushate zgjedhore tepër konkurruese. Është normale të shohësh një farë shkalle konkurrimi politik, pasi çdo parti përpiqet të paraqesë idetë e veta dhe të tërheqë zgjedhësit. Kjo është demokracia. Megjithatë, vullneti i mirë politik dhe respekti për shtetin e së drejtës dhe parimet demokratike janë parakushte thelbësore për të pasur një proces të suksesshëm zgjedhor. Kur partitë përdorin retorika nxitëse dhe shpifëse apo bëjnë përpjekje të politizojnë punën e administratës zgjedhore, dëmtohet besimi i publikut te procesi në tërësi. Megjithatë, përgatitja dhe zhvillimi i mirë i zgjedhjeve nuk mund të merren si të mirëqenë. Në fund, përgjegjësia mbetet kryesisht në duart e drejtuesve politikë të vendit. Ata kanë kapacitet thuajse të pakufizuar për të zhvilluar zgjedhje plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare; por, po ashtu, ata kanë edhe kapacitetin për ta përmbysur tërësisht procesin. U takon atyre të përdorin, me përgjegjshmëri, fuqinë e madhe që u është dhënë”.

ADN: Maxhoranca dhe opozita ‘luftojnë’ jo vetëm në lidhje me zgjedhjet; një tjetër aspekt është integrimi në BE dhe pikërisht tre projektligjet që presin miratimin nga parlamenti.

Përballë ngurrimit të opozitës për t'i mbështetur këto projektligje, kryeministri Sali Berisha ka bërë thirrje për referendum. Cili është opinionimi juaj për këtë nismë të re dhe problemet që lidhen me statusin e vendit kandidat për Shqipërinë?

Ambasadori Wollfarth: “Këto tri projekte të rëndësishme, dy ligje dhe Rregullorja e Kuvendit, që kërkojnë një shumicë prej tri të pestash dhe që tani përmenden si “tri projektligjet”, janë hapa drejt reformave thelbësore që i nevojiten një vendi demokratik të bazuar në shtetin e së drejtës. Paketa për reformën parlamentare dhe ligji i ri për shërbimin civil mund të përbëjnë bazën për një reformë serioze me qëllim për të pasur një administratë publike transparente dhe meritokratike. Ndryshimet në ligjin për Gjykatën e Lartë mund të shihen si një hap i rëndësishëm në fushën e reformës në drejtësi, duke përfshirë edhe aspekte të rëndësishme si efikasiteti në luftën kundër korrupsionit. Si të tillë, këto ligje janë të rëndësishme për Shqipërinë në rrugën e saj të zbatimit të vlerave demokratike bazë, të nevojshme për të qenë lidhur ngushtë me shtetin e së drejtës. Por mund të ritheksoj rëndësinë e vullnetit politik për zbatimin e reformave të vërteta, si dhe rëndësinë e zbatimit të ligjeve që tashmë janë në fuqi. Situata aktuale duhet parë si një mundësi për politikanët shqiptarë të të dyja kampeve që të tregojnë se kanë pjekurinë politike për të bashkëpunuar”.

ADN: Asistenca e OSBE-së në Shqipëri nuk ofrohet vetëm për çështjet zgjedhore. Asistenca juaj shtrihet edhe në fusha të tjera. A mund të na thoni, ju lutem, diçka më shumë në këtë aspekt? Cilat janë disa prej projekteve aktuale të OSBE-së dhe projektet e reja në të ardhmen?

Ambasadori Wollfarth: “Prezenca është mandatuar për të promovuar demokratizimin, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe mirëqeverisjen në Shqipëri, në pajtim me parimet, standardet dhe angazhimet e OSBE-së. Të gjitha këto detyra janë projekte afatgjata. Në bazë të mandatit, puna jonë shtrihet nga reforma legjislative, gjyqësore dhe parlamentare deri te lufta kundër korrupsionit dhe trafikimit, te përforcimi i medias së pavarur, ndërtimi i shoqërisë civile dhe asistenca ofruar policisë. Për shembull, Prezenca ka mbështetur krijimin e institucioneve të reja, si institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Shërbimin e Provës. Ne marrim pjesë edhe në reformën në proces të Kodit të Procedurës Penale dhe Civile, në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë. Kemi asistuar edhe strukturat kombëtare, si Inspektoratin e Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, në drejtim të përmirësimit të kapaciteteve të tij për të luftuar korrupsionin. Gjithashtu, ne punojmë ngushtë me Ministrinë e Mbrojtjes për asgjësimin e municioneve të tepërta konvencionale dhe të kimikateve të rrezikshme. Do të doja të theksoja edhe perspektivën rajonale, ndërkuftare, të pranishme në shumë prej veprimtarive tona si, për shembull, në drejtim të përforcimit të menaxhimit të kufirit dhe bashkëpunimit për sigurinë e kufirit, nëpërmjet mbështetjes tonë për shkëmbim informacioni dhe aktivitete të tjera të përbashkëta midis Policisë Shqiptare të Kufirit dhe Migracionit dhe homologëve të veta në vendet fqinje. Pikat e përbashkëta të kalimit kufitar, si ajo e Muriqanit, janë rezultat i drejtpërdrejtë i punës sonë”.

ADN: Një retorikë nacionaliste, që ka bërë jehonë në Shqipëri kohët e fundit, duke arritur kulmin gjatë festimeve të 100 vjetorit të pavarësisë, është ndeshur me reagime të ashpra të vendeve fqinje si Greqia, Serbia dhe Maqedonia, disa prej të cilave pretendojnë se pas saj fshihet skema e Shqipërisë së Madhe. Gjithashtu, disa partnerë ndërkombëtarë të Shqipërisë kanë bërë thirrje për vetëpërmbytje dhe kanë këshilluar shmangien nga ‘ethet’ nacionaliste. A do të thotë kjo se Shqipëria e ka humbur tashmë imazhin e faktorit të paqes dhe stabilitetit në rajon? Cili është mesazhi juaj ndaj këtij nacionalizmi shqiptar dhe pse jo ndaj diçkaje të ngjashme që vihet re edhe vende të tjera të Ballkanit?

Ambasadori Wollfarth: “Shqipëria, gjatë pjesës më të madhe të dy dekadave të fundit, ka luajtur një rol konstruktiv dhe stabilizues në rajon. Megjithatë, retorika e fundit e disa prej drejtuesve politikë shqiptarë është dukshëm jo në përputhje me këtë traditë. Ne i mirëpresim dhe i inkurajojmë diskutimet politike të përgjegjshme dhe i nxisim të gjitha palët të shmangin deklaratat apo veprimet që do të rrisnin tensionin në rajon. Axhenda e reformave ecën paralel me axhendën e integritimit. Puna e madhe duhet bërë brenda vendit. Në vend që të bëjnë deklaratat nxitëse për mundësinë e një bashkimi politik, drejtuesit politikë duhet t’ua përkushtojnë energjinë e tyre reformave të nevojshme për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, me qëllim për të bërë hapa të mëtejshëm drejt integritimit evropian. Kjo është ajo çka duhet bërë dhe kjo është, sipas perceptimit tonë, ajo çka shumica e shqiptarëve duan dhe meritojnë”.

ADN: Le t’i kthehemi jetës së përditshme në Shqipëri. Është krijuar përshtypja se të qenit Ambasador do të thotë të kesh informacione të kufizuara për Shqipërinë dhe zhvillimet në të gjitha fushat e jetës – që vjen nga politikanë, intelektualë si gazetarët, shkrimtarët, artistët, etj. Si komunikoni me njerëzit e thjeshtë për të parë mendimet e tyre, shqetësimet dhe sugjerimet, pasi ata përbëjnë shumicën absolute të popullsisë së vendit?

Ambasadori Wollfarth: “Fatmirësisht, duhet të them se burimet e mia të informacionit nuk kufizohen nga ato çka mund të konsiderohen stereotipe. Që kur arrita në Shqipëri, kam bërë përpjekje të vazhdueshme për të ndërvepruar me të gjitha segmentet e popullsisë – ku kuptohet që përfshihen edhe qytetarët e zakonshëm. Unë gjithashtu drejtoj një staf, tre të katërtat e të cilit janë qytetarë shqiptarë. Ata më ndihmojnë të kuptoj më mirë shqetësimet e qytetarëve, brengat dhe sfidat e përditshme të popullit, familjeve dhe individëve. Ju me siguri e keni venë re që unë marr pjesë në shumë takime dhe biseda dhe që jam në kontakt me një gamë të gjerë njerëzish. Më pëlqen të flas me ta për shqetësimet dhe shpresat e tyre për të ardhmen. Më ka bërë përshtypje njohja e tyre e thellë që kanë ndarë lidhur me shoqërinë, kulturën dhe jetën politike në Shqipëri. Duket qartë që kanë njëfarë shqetësimi për të ardhmen dhe presin me të drejtë që drejtuesit politik të të gjitha niveleve, qoftë qendror apo vendor, të bëjnë përpjekje serioze për të punuar së bashku në mënyrë konstruktive, për të mirën e vendit”.

ADN: Në vijim të pyetjes më sipër. Si ndiheni, si z. Eugen, në jetën e përditshme në Tiranë apo në zonat e tjera të Shqipërisë? Ju udhëtoni shpesh në kohën tuaj të lirë. Mund të them se nuk i shpëtoni syrit të shqiptarëve të thjeshtë kur jeni në vende publike, jo vetëm për shkak të statusit tuaj diplomatik por edhe për shkak të staturës suaj, që tërheq syrin e publikut.

Ambasadori Wollfarth: [buzëqesh] “Sigurisht që Shqipëria është shumë më shumë se vetëm kryeqyteti i saj. Për këtë arsye, shumë shpejt pas ardhjes sime në këtë post, udhëtova shumë nëpër Shqipëri, jo vetëm në kohën e lirë, por edhe në cilësinë time si Kryetar i Prezencës së OSBE-së. Këtë e bëjnë më të lehtë dy fakte: njerëzit e mrekullueshëm të këtij vendi, të cilët meritojnë më shumë vëmendje, si dhe fakti që shumë pjesë të Shqipërisë janë vërtet të bukura. Njerëzit dhe natyra, veçanërisht mjedisi, kanë nevojë për më shumë vëmendje, si në nivel qendror ashtu edhe vendor. Vëmendjen tonë e kanë me siguri. Sa i përket staturës sime – vërtet jam i gjatë – ajo e lehtëson tërheqjen e vëmendjes. Por nuk e shoh si barrë. Përkundrazi, e shoh në mënyrë pozitive, sepse tregon edhe që imazhi i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri është i njohur për qytetarët dhe kjo na e bën më të lehtë përmbushjen e qëllimit tonë të përgjithshëm në shërbim të qytetarëve shqiptarë – promovimin e demokratizimit, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut, si dhe konsolidimin e institucioneve demokratike

në pajtim me parimet, standardet dhe angazhimet e OSBE-së. Dhe, mos harroni, vetë Shqipëria është pjesë aktive e familjes së Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së, duke ndihmuar në mbështetjen që i ofrojmë këtij vendi të mrekullueshëm”.

Fund